



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

4011
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 02. 08. 2013

UDHËZIM

Nr. 24, datë 02. 8. 2013

PËR

**CERTIFIKIMIN E HARTUESVE TË TESTEVE DHE VLERËSUESVE NË PROVIMET
KOMBËTARE**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 49 të Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Kandidati për hartimin e testeve lëndore ose vlerësues në provimet kombëtare, më tutje "kandidati", është mësuesi që:
 - a) zotëron diplomën universitare në mësuesi për lëndën përkatëse;
 - b) ka dhënë lëndën të paktën një herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor;
 - c) ka 5 vjet përvojë si mësues.
2. Mësuesi, që i është nënshtruar provimit të kualifikimit, është kandidat, kur është vlerësuar me të paktën "mirë" në këtë provim.
Parapëlqehen mësuesit që janë vlerësuar me të paktën "shumë mirë".
3. Kandidati për hartues të testeve lëndore në provimet kombëtare ose vlerësues në provimet e maturës shtetërore paraqet pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), kurse kandidati për vlerësimin në provimet e lirimit paraqet pranë njësisë arsimore vendore përkatëse (DAR/ZA):
 - a) CV-në e tij sipas modelit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 - b) Dy rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të njësisë arsimore vendore për cilësinë e punës së tij dhe qëndrimin e tij etik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 2222260, Fax : +355 4 2232002

Web site: www.mash.gov.al

4. Kandidatët marrin pjesë në një kurs afatshkurtër, me materiale të përgatitura nga AKP dhe të miratuara nga MASH.
5. Kandidatët për hartimin e testeve lëndore ose për vlerësimin në provimet e maturës shtetërore:
 - a) marrin pjesë në kursin afatshkurtër të zhvilluar nga specialistë të AKP-së;
 - b) i nënshtrohen provimit me teste të hartuara nga AKP;
 - c) pajisen me certifikatën përkatëse kur përfundojnë me sukses provimin.
6. Kandidatët për vlerësimin në provimet e lirimit:
 - a) marrin pjesë në kursin afatshkurtër të zhvilluar nga specialistë të sektorit të kurrikulës në njësinë arsimore vendore, të cilët përgatiten paraprakisht nga specialist të AKP-së;
 - b) pajisen me certifikatën përkatëse kur kanë marrë pjesë në të gjitha seancat e kursit afatshkurtër.
7. AKP dhe DAR/ZA-të:
 - a) publikojnë në faqen e tyre të internetit materialet për hartimin e testeve lëndore dhe vlerësimin;
 - a) datat e kurseve afatshkurtra që zhvillohen nga AKP dhe DAR/ZA-ja;
 - b) datat e provimeve dhe vendin e zhvillimit të tyre për AKP.
8. AKP harton dokumentin që përshkruan:
 - a) procedurat e zhvillimit të provimit të kandidatëve;
 - b) procedurat e vlerësimit të kandidatëve;
 - c) formatin dhe përmbajtjen e certifikatës të lëshuar nga AKP dhe DAR/ZA.
9. Kanë të drejtë të hartojnë teste lëndore dhe të vlerësojnë në provimet kombëtare vetëm mësuesit e certifikuar sipas këtij Udhëzimi.
10. Certifikata për provimet e maturës shtetërore është e vlefshme edhe për provimet e lirimit.
Mësuesi, i certifikuar për provimet e lirimit, e fiton certifikatën e provimeve të maturës shtetërore pasi të përfundojë me sukses provimin përkatës të vlerësimit.
11. AKP përzgjedh për një vit shkollor mësuesit e certifikuar prej saj si hartues të testeve lëndore dhe vlerësues në maturën shtetërore.
12. DAR/ZA përzgjedh për një vit të shkollor mësuesit e certifikuar si vlerësues të provimeve të lirimit.
13. Certifikata e kandidatëve fitues lëshohet nga:

- a) AKP për hartimin e testeve lëndore dhe vlerësimin në provimet e maturës shtetërore;
- b) DAR/ZA-ja për vlerësimin në provimet e lirimit; dhe firmoset e vuloset nga titullari përkatës.

14. Certifikata është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MYQEREM TAJ

MINISTËR

